



## “Kapuni fort për çiltërsinë, sepse çiltërsia shpie në mirësi, ndërsa mirësia shpie në Xhenet

Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kapuni fort për çiltërsinë, sepse çiltërsia shpie në mirësi, ndërsa mirësia shpie në Xhenet. Njeriu vazhdon të jetë i çiltër dhe ta synojë çiltërsinë, derisa të shkruhet shumë i çiltër tek Allahu. Ruajuni gënjeshtërs, sepse gënjeshtër shpie në shturje, ndërsa shturja shpie në Zjarr. Njeriu vazhdon të gënjejë dhe ta synojë gënjeshtërin, derisa të shkruhet gënjeshtar i madh tek Allahu.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith ka urdhëruar të jemi të çiltër dhe ka treguar se, nëse i përmbahemi asaj, ajo do të na shpjerë në vepra të mira të përhershme. Atë që në vazhdimësi bën vepra të mira, ato e dërgojnë në Xhenet. Njeriu në vazhdimësi tregohet i çiltër, si në fshehtësi dhe haptazi, kështu do ta meritojë emrin: shumë i çiltër. Pastaj Profeti ﷺ tërhoqi vërejtjen kundër gënjeshtërs dhe të folurit të së kotës, sepse ajo i largon njerëzit nga qëndrueshmëria në fe dhe i nxit të bëjnë vepra të këqija, shkatërrim dhe gjynahe, e kështu i shpien në Zjarr. Njeriu vazhdon të gënjejë shpesh, derisa të shkruhet tek Allahu prej gënjeshtarëve.

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5504>

